

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës IV (Mjedisi)

Sesioni 4 "Mbrotjtja e Mjedisit nëpërmjet Legjislacionit Penal"

17 Dhjetor 2015

Zhvillimet aktuale

Ndërkohë që debati publik në nivel botëror në lidhje me mjedisin është përqëndruar tashmë tek çështja e ndryshimeve të klimës dhe masave urgjente që duhen ndërmarrë për të parandaluar dhe zbutur këtë fenomen, Shqipëria është ende shumë mbrapa në aspektet më elementare të mbrojtjes së mjedisit. Për të ilustruar më mirë këtë prapambetje, Grupi i Punës solli shembullin e aksidentit mjedisor të ndodhur në Gjirin e Meksikës (Deep Water Horizon 2010) dhe masat e marra pas tij të cilat u krahasuan me masat e marra nga shteti Shqiptar me rastin e aksidentit mjedisor të ndodhur si pasojë e shpërthimit të puseve të naftës të punuara nga Bankers Petroleum në Fier. Krahasimi nxorri në pah se masat e marra nga shteti shqiptar ishin shumë të lehta (pezullim i përkohshëm i aktivitetit) dhe se kryesisht mungoi transparenca institucionale dhe mediatike në dhënien e informacioneve mbi pasojat afat-gjata në mjedis të aksidentit, mbi përgjegjësitë përkatëse dhe përfundimeve të arritura nga hetimet e kryera në lidhje me këtë aksident.

Grupi i punës diskutoi mbi ndryshimet e legjislacionit të Bashkimit BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe atij shqiptar. U përmend Direktiva 2008/99/EC, për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacioni penal, e cila përmban një listë shkeljesh mjedisore që duhet të trajtohen *si krime mjedisore* nga shtetet antare dhe përbën një nga risitë thelbësore në fushën e mbrojtjes së mjedisit për vetë BE-në. Përshembull Direktiva forcon sistemin e mbrojtjes së mjedisit në vendet e BE-së duke parashikuar se do të konsiderohen krime mjedisore edhe një sërë shkeljesh të kryera me faj të rëndë dhe se shoqëritë tregtare në emër të të cilave kryhen krimet mjedisore do të dënohen gjithashtu me një sërë penaltitësh të tjera të përshtatshme për shoqëritë tregtare, siç janë masat administrative si gjobat, pezullimi i veprimtarisë, heqja e të drejtës për të lidhur kontrata me shtetin etj. Ndryshe paraqitet situata e mbrojtjes së mjedisit e rregulluar nga Kodi Penal shqiptar. Përshembull në nenet 201 dhe 203 të KP-së penalizohet vetëm ndotja e ajrit por nuk përfshihet ndotja e tokës apo dëmet ndaj tokës, kafshëve dhe bimëve. Gjithashtu Neni 202 i KP-së trajton në mënyrë të kufizuar vetëm veprimtarinë e transportit të mbetjeve toksike dhe radiokative që kalojnë dhe depozitohen në Shqipëri por nuk trajton të gjithë veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve. Një tjetër mangësi është fakti që ndryshe nga legjislacioni i BE-së i cili rregullon dhe penalizon veprimtaritë e rrezikshme në rastet e kryerjes së krimeve mjedisore, legjislacioni shqiptar apo Kodi Penal nuk përmban nene specifike që të rregullojë në mënyrë organike veprimtaritë e rrezikshme industriale. Pra legjislacioni shqiptar dhe veçanërisht Kodi

Penal janë shumë të kufizuar dhe nuk janë ende në përputhje me standartet Evropiane të mbrojtjes së mjedisit. Për këtë arsye është pozitive iniciativa për të realizuar një projektligj për forcimin dhe ndryshimin e legjislacionit penal shqiptar për mbrojtjen e mjedisit në rast se kjo iniciativë do të përfundojë me sukses.

Probleme & Rekomandime

Ndryshim i legjislacionit penal shqiptar për mbrojtjen e mjedisit

Kodi Penal shqiptar aktualisht parashikon vetëm 9 nene për mbrojtjen e Mjedisit të cilat janë shumë të kufizuara në llojin e veprimtarive të ndotjes së mjedisit që dënohen. Reforma e pjesës së Kodit Penal për mbrojtjen e mjedisit duhet të synojë së paku të ngrihet në standartet e Direktivës 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit. Thelbësore është parashikimi i dënimit për ndotjen e tokës e cila nuk rezulton e përfshirë si vepër penale më vete. Kodi Penal duhet gjithashtu të parashikojë dënime të posaçme për veprimtaritë ndotëse të zonave të mbrojtura, mbrojtjen e faunës dhe florës si dhe tregtimin e specieve të mbrojtura. Dënime specifike duhet të parashikohen edhe për veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve në rastet kur kjo e fundit kryhet në kundërshtim me parametrat ligjore dhe shkakton ndotje në mjedis. Në përgjithësi i gjithë Kapitulli IV i Kodit Penal duhet të rishikohet në frymën e Direktivës 2008/99/EC dhe me synimin që të sanksionojë ndotjet e mëdha të veprimtarive industriale me dënime penale të përshtatshme duke patur kujdes që ndotjet më të vogla të sanksionohen me masa të llojeve të tjera të tilla si gjობat. Nga ana tjetër, siç kërkohet nga Direktiva, duhen parashikuar masa të përshtatshme jo penale për dënimin e shoqërive që kryejnë krime mjedisore si p.sh masa administrative, gjობa, pezullim aktiviteti, heqja e të drejtës për të lidhur kontrata me shtetin etj.

Rritja e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e mjedisit nga ndotja

Ndërgjegjësimi i qytetarëve shqiptar në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja është shumë i ulët krahasuar me nivelin e ndotjes së mjedisit në Shqipëri. Ka një mungesë të theksuar informacioni mbi gjendjen e ndotjes së mjedisit dhe veçanërisht të pasojave të ndotjes mbi shëndetin e njeriut. Reforma e kodit penal në mënyrën e përmendur më sipër, përveç përforcimit të legjislacionit, mund të sjellë si aspekt tjetër pozitiv edhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit duke qënë se legjislacioni penal, për shkak të karakterit të saj më shtrëngues, rrit vëmendjen e qytetarëve ndaj çështjeve të rregulluara prej tij. Gjithashtu ndërgjegjësimi kërkon rritjen e aksesit të publikut ndaj informacioneve mbi ndotjen mjedisore dhe analizave të detajuara dhe lehtësisht të kuptueshme nga qytetarët e pa specializuar mbi pasojat e ndotjes mjedisore.

Forcimi i institucioneve shtetërore me kompetencë mbrojtjen e mjedisit

Ka një sërë institucioneve shtetërore të cilat kanë kompetenca në luftën kundër ndotjes së mjedisit të tilla si organet e ministrisë së mjedisit, inspektoriat i mjedisit, agjencia kombëtare e mjedisit deri tek gjykatat. Një nga problemet thelbësore shqiptare në fushën e zbatimit të ligjit është korrupsioni, për këtë arsye zbatimi real i politikave anti-korrupsion është një nga elementet kyç edhe për realizimin e luftës kundër ndotjes së mjedisit. Elementi i dytë është rritja e kapaciteteve dhe ekspertizës së organeve ligj-zbatuese në çështjet e ndotjes mjedisore nëpërmjet vendosjes në dispozicion të burimeve financiare, teknike dhe njerëzore. Veçanërisht organet ligj-zbatuese të tilla si inspektoriat i mjedisit dhe agjencia kombëtare e mjedisit kanë nevojë të pajisen me teknologji të përshtatshme dhe staf të mirëtrajnuar mbi çështjet e ndotjes së mjedisit. Nga ana tjetër organet hetuese si prokuroria dhe organet gjyqësore, të cilat deri më tani nuk kanë trajtuar në mënyrë të konsiderueshme çështje të mbrojtjes së mjedisit, kanë nevojë urgjente për të rritur ekspertizën e tyre në hetimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve. Gjithashtu do të ishte shumë e dobishme të ngrihej një sistem bashkëpunimi të ndërsjellë dhe shkëmbimi të informacioneve midis të gjitha institucioneve të cilat ushtrjnë kompetenca në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.

Transparencë në lidhje me procedurat dhe mbarëvajtjen e hetimeve ndaj aksidenteve mjedisore

Opinion i publik shqiptar, vihet herë pas here në dijeni mbi aksidente mjedisore të ndodhura si pasojë e veprimtarive industriale. Informacioni jepet kryesisht në rrugë mediatike dhe nuk ndiqet nga raporte të detajuara zyrtare në lidhje me masat e marra. Për këtë arsye ka një nevojë të theksuar të rritjes së transparencës të institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe aksesit të publikut në informacionin zyrtar mbas çdo aksidenti mjedisor. Transparenca institucionale duhet të përfshijë të paktën pikat e mëposhtme:

- të jepet informacion zyrtar mbi arsyet e aksidentit, llojin e ndotjes, dëmit afat shkurtër dhe afat gjatë në mjedis dhe në shëndetin e qytetarëve;
- të kryhen dhe të bëhen publike analizat zyrtare mbi rrezikshmërinë e substancave të lëshuara në mjedis dhe pasojave të tyre;
- të jepet informacion mbi përfundimet e hetimit, fazave të proceseve gjyqësore, përgjegjësitë individuale, masave administrative dhe/ose penale që merren kundër shoqërive apo individëve dhe dëmshpërblimeve të dhëna ndaj qytetarëve të prekur.

Pjesëmarrës nga Institucione shtetërore dhe OJF në Sesionin 4, të Grupit të Punës IV

Ekspertë të Grupeve të Punës: z. Ondrej Koporec, Policia Sllovaqe; znj. Holta Ymeri, EMA;

Institucione Shtetërore:

Ministria e Mjedisit: znj. Florinda Avdulla;

Ministria e Integrimit: znj. Eriglenda Pasmaçiu

Agjencia Kombëtare e Mjedisit: Znj. Erinda Misho

Përfaqësues të Shoqërisë Civile:

PPNEA: Z. Elkonis Buhaljoti

LFC-Albania: Z. Florian Xhafa, Znj. Suela Hasani

EDEN: znj. Herda Paço

Ekolëvizja: Znj. Alisa Peçi

GGroup : Z. Sazan Guri

ECAT Tirana: Znj. Marieta Mima

DM Cosulting: Z. Silvin Laze, Z. Roland Deda